

KNF - Të Rinjtë në Biznes në Ballkanin Perëndimor - Banka për Biznes

Shteti: KOSOVË

Projekti Nr.: 53840

Spektori i biznesit: Kredi jo-depozitare (jo-bankare)

Lloji i Njoftimit: PRIVAT

Kategoria Mjedisore: FI

Data e Synuar e Aprovimit: 05 korrik 2022

Statusi: Në eksplorim, më shqyrtim përfundimtar

DPP i shpalosur: 05 korrik 2022

Përshkrimi i projektit

Sigurimi i një huaje senior të pasiguar deri në 4.5 milionë EURO, e cila do të vihet në dispozicion në tri këste të barabarta për Banka për Biznes ("BpB") në kuadër të Programit për të Rinjtë në Biznes në Ballkanin Perëndimor ("WB YIB").

Objektivat e Projektit

Të ardhurat nga huaja do të përdoren për huadhënie për ndërmarrjet e pranueshme mikro, të vogla dhe të mesme ("NMVM"), të cilat janë nën përgjegjësinë e përgjithshme të menaxhimit operacional ose me shumicë të aksioneve nën pronësi të një personi (ose personave) nën moshën 35 vjeç ("NMVM-të e të rinjve") në Kosovë në përputhje me Deklaratën e Politikës.

Ndikimi i Tranzicionit

ETI 72

Projekti kontribuon në objektivat e KNF-së (Kornizës për Ndërmjetësuesit Financiarë), duke mbështetur cilësitë e Ndikimit të Tranzicionit si **Gjithëpërfshirës** dhe **Konkurrues**:

Gjithëpërfshirës: Projekti do të kontribuojë në përfshirjen ekonomike të ndërmarrësve të rinj duke mbështetur qasjen e NMVM-ve të të rinjve në financa dhe shërbime këshillimore për biznesin, duke demonstruar edhe argumente afariste për rritjen e shkallës së huadhënies për segmentin e NMVM-ve të të rinjve.

Konkurrues: Ndikimi i tranzicionit pritët të derivohet nga zgjerimi i tregut dhe përmes ndërtimit të një sektori financiar më konkurrues, si dhe duke forcuar

kapacitetin e Institucioneve Financiare Partnere (IFP) për financimin e NMVM-ve të rinjve.

Informata për Klientin

BANKA PER BIZNES SHA

Banka për Biznes Sh.A., është bankë e nivelit të dytë në Kosovë që ofron një gamë të gjerë të produkteve bankare komerciale për të gjitha segmentet e klientëve, me fokus kryesor në NMVM-të dhe shitjet me pakicë. BpB, e themeluar në vitin 2001, është banka e shtatë nga madhësia në Kosovë në mesin e 11 bankave që operojnë në treg, dhe sipas të dhënave për VF2021 zotëron një pjesë të tregut prej 7.0% sipas totalit të aseteve dhe 6.8% sipas kredive neto. BERZH u bë aksionar në BpB në vitin 2010 me blerjen e 10.0% të aksioneve, ndërsa pjesa e mbetur e aksioneve u mbajtën nga afaristë kosovarë (77.6%), Moneta Sh.p.k. (7.8%) dhe Banka di Cividale (4.6%).

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

4,500,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

4,500,000.00 EURO

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria FI (PMS 2019). BpB është klient ekzistues dhe deri më sot i ka dorëzuar Bankës Raporte të kënaqshme Vjetore për çështjet Mjedisore dhe Sociale. BpB-së do t'i kërkohet të vazhdojë të zbatojë procedurën e menaxhimit të riskut mjedisor dhe social për kreditë për ndërmarrje mikro, NVM-të dhe korporatat; të vazhdojë të jetë në pajtueshmëri me Kërkesat e Performancës (KP-të) 2, 4 dhe 9 të BERZH-it, duke përfshirë respektimin e Listës së zgjeruar të Përrjashtimit për MS dhe Listës për Referime të BERZH-it të prezantuar me PMS 2019, si dhe të dorëzojë në Bankë Raporte Vjetore për MS.

BpB-së do t'i kërkohet gjithashtu të zhvillojë dhe zbatojë një sistem të menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS), të njihet me manualin elektronik të BERZH-it për IF-të, si dhe të ketë staf të dedikuar për MS që kalojnë një Program të Mësimit Elektronik për Menaxhimin e Riskut Mjedisor dhe Social për Ndërmjetësuesit Financiarë.

Bashkëpunimi Teknik

BT: Programi mbështetet nga fondet për BT, të siguruar nga qeveria e Suedisë, në shumën prej 3.54 milionë eurosh (gjithsej për Programin), dhe në këtë rast do të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të BpB-së dhe gjithashtu të NMVM-ve të rinjve.

Jo BT: Deri në 0.45 milionë euro sigurohen nga Fondi i Posaçëm i Aksionarëve të BERZH-it në formën e Mbulimit të Riskut të Humbjes së Parë për BpB-në në përputhje me Deklaratën e Politikës.

Shtesë

Shtesa arrihet duke kombinuar financimin e nevojshëm afatgjatë me BT-në dhe Mbulimin e Riskut të Humbjes së Parë në një paketë që promovon investimet në NMM-të e të rinjë në Kosovë.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Adonis Bllacaku
adonis.bllacaku@bpbbank.com
+383 49 904 804
www.bpbbank.com
Rr. Ukshin Hoti, Nr. 128, Prishtinë 10000, Kosovë

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni [Prokurimet e BERZH](#):

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor

dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efektive për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rrezeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt.

OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktikën mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke [përdorur Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimit)

në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH .

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e webit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.